

20140411168

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR VEPRIMTARI INOVATIVE

Neni 1

Në Ligjin për veprimtari inovative (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 79/13 dhe 137/132) në nenin 30 paragrafi 11 pas fjalës “vijon” shtohet fjala “mujo”, kurse fjalët: “në bazë të prezencës në mbledhjet e Këshillit Drejtues” zëvendësohen me fjalët: “i cili paguhet nëse gjatë muajit ka mbajtur së paku një mbledhje dhe vetëm kryetarit dhe anëtarëve që kanë marrë pjesë në mbledhje, përkatësisht mbledhjet e Këshillit Drejtues”.

Neni 2

Në nenin 32 paragrafi 1 pika në fund të fjalisë shlyhet dhe shtohen fjalët: “e cila botohet në së paku tri gazeta ditore të cilat botohen në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë, nga të cilat njëra nga gazetatat që botohet në gjuhën që e flasin së paku 20% nga qytetarët që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase. “

Paragrafi 5 ndryshon si vijon:

“Për drejtor të Fondit mund të zgjidhet personi i cili i plotëson këto kushte:

- 1) është shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- 2) në momentin e emërimit me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalim për ushtrim të profesionit, veprimtari ose detyrës;
- 3) ka marrë së paku 240 kredi sipas SETK ose të mbaruar shkallën VII/1 nga sfera e shkencave ekonomike ose teknike teknologjike;
- 4) ka minimum pesë vjet përvojë pune në lëmi;
- 5) posedon një nga certifikatat e pranuar ndërkombëtare vijuese ose vërtetim për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:
 - TOEFEL IBT së paku 74 pikë,
 - IELTS (IELTS) – së paku 6 pikë,
 - ILEC (ILEC) (Cambridge English: Legal) - së paku niveli B2 (B2),
 - FCE (FCE) (Cambridge English: First) – i dhënë,
 - BULATS (BULATS) – së paku 60 pikë ose
 - APTIS (APTIS) – së paku niveli B2 (B2) dhe
- 6) ka dhënë test psikologjik dhe test për integritet.”

Neni 3

Në nenin 37 paragrafi 2 ndryshon si vijon:

“Për të punësuarit në Fond të cilat kryejnë punë administrative zbatohen dispozitat nga Ligji për nëpunës administrativë dhe Ligji për të punësuarit në sektorin publik, kurse për të punësuarit që kryejnë punë ndihmëse teknike zbatohen dispozitat nga Ligji për të punësuarit në sektorin publik dhe Ligji për marrëdhënie pune.“

Neni 4

Drejtori i Fondit për Inovacion dhe Zhvillim Teknologjik i emëruar deri në ditën e fillimit të zbatimit të nenit 2 të këtij ligji vazhdon ta ushtrojë funksionin deri në skadimin e mandatit për të cilin është emëruar .

Neni 5

Autorizohet Komisioni juridik ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë që të përcaktoj tekst të spastruar të Ligjit për veprimtari inovative .

Neni 6

Dispozitat nga neni 2 nga ky ligj do të fillojnë të zbatohen në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç dispozitave që kanë të bëjnë me kushtin për njohje të gjuhës së huaj që do të fillojnë të zbatohen pas dy vitesh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Dispozitat nga neni 3 i këtij ligji do të fillojnë të zbatohen me ditën e fillimit të zbatimit të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë ” numër 27/14) dhe Ligji për nëpunës administrativë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë ” numër 27/14) .

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.